

# MACROSAN PRONTO CALCE

## SUVA KUNDER LAGESHTIRES E GATSHME PER PERDORIM

### Karakteristika

**MACROSAN PRONTO CALCE** është një llaç i parapërzier i gatshëm për përdorim për t'u përzier veç me ujë, i përbërë nga një përzierje gëlqereje hidraulike dhe gëlqereje hidrate, shtesash kimike specifike, fibrash sintetike dhe lëndësh inerte të thërrmuara të përzgjedhura. Pas përzierjes përftohet një llaç tiksotropik me plasticitet, mjaft mirë e punueshme, shumë e ajrosur dhe me aftësi të lartë kundër lagështirës.

### Fusha e përdorimit

**MACROSAN PRONTO CALCE** përdoret në muratura të brendshme e të jashtme, edhe të vjetra, që i nënshtrohet dukurisë së lagështisë për pjesë të dala kapilare. Duke u kombinuar me MACROSAL ose MACROSAN Rinzafo (mbushje/shtresim) shmang formimin e kristaleve kripore, shkak i degradimit dhe i shkëputjes së llaqeve tradicionale.

### Avantazhe

- mban të pandryshuar në kohë veprimin e tij kundër lagështirës
- i gatshëm për përdorim
- mundëson ripërdorimin e shpejtë të lokaleve
- aftësi të lartë avulluese

### Materialet e duhura

Muratura prej tullash/tjegullash, shtufi, miksturash edhe me interes historik  
Blloqe çimentoje (aplikim i mëparshëm i MACROSAN RINZAFFO).  
Çimento osmotike (për efekt antikondensimi apliko më parë MACROSAN RINZAFFO të dyja të freskëta).

### Përgatitje e sipërfaqeve

Të hiqet krejtësisht çdo gjurmë llaçi/suvaje apo materiali tjetër që nuk përputhet me muraturën për një lartësi të paktën 1 m përtej shenjës së dukshme të lagështirës. Hiq mekanikisht të gjitha pjesët e pakapura mirë ose që po shkëputen, depozitat e mundshme kripore dhe çdo gjurmë materialesh të papërshkueshme (katrama, mbulesa etj). Për të arritur një rrafshësi të muraturave jashtë plumbit dhe për të riparuar hapësira të mëdha boshe mbush me copa tulle ose tjegullash, duke përdorur **MACROSAN PRONTO CALCE** si solucion lidhës. Lag me ujë paretin e përgatitur në këtë mënyrë dhe apliko MACROSAL mbi sipërfaqen ende të lagur dhe brenda 5-10 min mbush/shtreso me MACROSAN RINZAFFO.

### Mënyra e përdorimit

Përziej me betonierë për të paktën 5 min çdo thes 25 kg **MACROSAN PRONTO CALCE** me rreth 4l ujë të pastër. Apliko MACROSAN RINZAFFO, të forcuar sa duhet, duke krijuar një shtresë maksimalisht 2 cm për

dorë e duke pasur kujdes që produkti të mos shkelet në këtë fazë dhe t'i jepet lustër me perdah sfungjeri. Suvaja duhet të ketë një trashësi minimumi 2 cm. Trashësi më të mëdha, por sidoqoftë nën 4 cm, duhen realizuar duke bërë disa kalime sipas një rregulli të caktuar. Të paktën pas 2-3 javësh të zbukurohet me dekoracione tejet poroze të linjës MACROSAN ose MACROCOLOR ose të bëhet rrafshimi me MACRORASO.

## Të dhënat teknike dhe aplikative

- Pamja	pluhur ngjyrë lajthi
- Pesha specifike e llaçit të freskët	rreth 1.650 kg/m <sup>3</sup>
- Ambalazhimi	thes 25 kg
- Konsumi i mesëm/20mm trashësi	28-30 kg pluhur/m <sup>2</sup>
- Uji i përzierjes	rreth 16 %
- Qëndrueshmëria në shtypje (28 ditë)	3 N/mm <sup>2</sup>
- Koha e zgjatjes së përzierjes (20° C)	rreth 1 orë
- Diametri max inert	3 mm
- Koha e përzierjes	rreth 5 min
- Ajri i bllokuar	≥ 25%
- Trashësia min	20 mm
- Trashësia max për dorë	15-20 mm
- Temperatura e përdorimit	+5 / +35° C
- Koha e ruajtjes	12 muaj nëse mbahet në vend të thatë e të freskët në ambalazhin origjinal të vulosur

\*\* Betonierë, shtalka anësore, perdah, mistri

## Paralajmërime

- \*\* Mos e përdor mbi sipërfaqe tepër të nxehta, ku fryn erë e fortë apo në pishë të diellit
- \*\* Mos e përdor mbi sipërfaqe të ngrira ose që mund të ngrihen gjatë 24 orëve të ardhshme
- \*\* Mos i shto ujë apo tjetër gjë produktit të përzier
- \*\* Mos e përdor mbi sipërfaqe allçie
- \*\* Mbaje suvanë larg përqendrimeve të ujit
- \*\* Në rast temperaturash të larta mbaje sipërfaqen të lagur për 24 orë

## Qëndrueshmëri mekanike:

Qëndrueshmëritë mekanike, të pasqyruara në tabelë, janë nxjerrë nga mostra 4 x 4 x 16 cm, të ambalazuara në laborator me 16 % ujë dhe të maturuara në 20°C dhe U.R. 90%. Të dhënat mund të ndryshojnë ndërkohë që ndryshojnë kushtet e përzierjes e të staxhionimit.

Vërej: Vlera të tilla u referohen provave laboratorike në mjedis të kushtëzuar dhe mund të modifikohen ndjeshëm nga kushtet e vënies në përdorim.